
CIVIL JUDGMENT SYSTEM IN SWITZERLAND - A GENERAL REVIEW OF THE SWITZERLAND CIVIL JUDGMENT SYSTEM

Xhemile Saliu

International Balkan University, Faculty of Law, North Macedonia, xhemile.saliu@ibu.edu.mk

Abstract: Switzerland is a member of the continental Europe system. However, the decisions of the Swiss Federal Court have considerable weight. Swiss substantive law is subject to Swiss federal law. However, from the point of view of judicial law, in the courts of each of the 26 Swiss cantons, different legal rules are applied. Trials in federal courts are subject to the Federal Law on Procedural Law and the Federal Law on the Federal Judicial Organization. 26 cantons, in the same segment possess ways of scope, possess different court rules. For example, if in one canton there are special commercial courts for commercial cases, in another canton there is no such division. The conditions for appealing a judgment vary from canton to canton. In addition to the diversity of laws governing trials that vary according to the canton's location, if some federal-level laws containing provisions on judgments are taken into account and the existence of a judicial right which is a step forward by the Federal Court, all this leads to a distrust of the legal system in Switzerland, which causes lawlessness. Because it is not possible to take as an example all the court proceedings from all the cantons, in order to give an example in our work the judicial right of the canton of Zurich has been taken and within its framework we have analyzed the Law on Civil Procedure and the Law on Judicial Organization. Despite the traditional importance of cantonal law, today more federal court rules have taken the place of cantonal law. On January 1, 2001, the federal law on civil law entered into force, and from that date the rules on federal law apply to competencies. Meanwhile, certain procedural issues are subject to the rules of the Federal Constitution. Therefore, taking into account all this, we will analyze these legal-judicial and civil issues in the canton of Zurich.

Keywords: Swiss Federal Court, Swiss Federal Law, Cantonal law, Canton of Zurich, Civil Procedure of Switzerland, Judicial Organization.

SISTEMI CIVIL I GJYKIMIT NË ZVICËR NJË RI-SHIKIM I PËRGJITHSHËM NË SISTEMIN E GJYKIMIT CIVIL TË ZVICRËS

Xhemile Saliu

Universiteti Ndërkombëtar Balkanik, Fakulteti Juridik, R.Maqedonisë së Veriut,
xhemile.saliu@ibu.edu.mk

Abstrakt: Zvicra është anëtare e sistemit të Evropës Kontinentale. Megjithatë, vendimet e Gjykatës Federale të Zvicrës kanë peshë të konsiderueshme. E drejta materiale zvicerane i nënshtrohet ligjit federal zviceran. Megjithatë, nga pikëpamja e së drejtës gjyqësore, në gjykatat e secilit prej 26 kantoneve zvicerane zbatohen rregulla të ndryshme juridike. Gjykimet në gjykatat federale i nënshtrohen Ligjit Federal mbi Ligjin Procedural dhe Ligjit Federal për Organizatën Gjyqësore Federale. 26 kantone, në të njëjtin segment kanë mënyra të shtrirjes, posedojnë rregulla të ndryshme gjyqësore. Për shembull, nëse në një kanton ka gjykata të posaçme tregtare për çështje tregtare, në një kanton tjetër nuk ka një ndarje të tillë. Kushtet për apelimin e një vendimi ndryshojnë nga kantoni në kanton. Përveç shumëllojshmërisë së ligjeve që rregullojnë gjykimet që ndryshojnë sipas vendndodhjes së kantonit, nëse merren parasysh disa ligje të nivelit federal që përmbajnë dispozita mbi vendimet dhe ekzistenca e një të drejte gjyqësore e cila është një hap përpara nga Gjykata Federale, e gjithë kjo çon në një mosbesim ndaj sistemit juridik në Zvicër, gjë që shkakton paligjshmëri. Për shkak se nuk është e mundur të merren si shembull të gjitha proceset gjyqësore nga të gjitha kantonet, për të dhënë shembull në punën tonë është marrë e drejta gjyqësore e kantonit të Cyrihut dhe në kuadër të tij kemi analizuar Ligjin për Procedurë Civile dhe Ligji për Organizimin Gjyqësor të këtij kantoni. Pavarësisht rëndësisë tradicionale të ligjit kantonal, sot më shumë rregulla të gjykatave federale kanë zënë vendin e ligjit kantonal. Më 1 janar 2001 hyri në fuqi ligji federal për të drejtën civile dhe që nga ajo datë zbatohen rregullat nga ligji federal për kompetencat gjyqësore. Ndërkohë, disa çështje procedurale i nënshtrohen rregullave të Kushtetutës Federale. Prandaj, duke marrë parasysh të gjitha këto, ne do t'i analizojmë këto çështje juridike dhe civile në kantonin e Cyrihut.

Fjalët kyçe: Gjykata Federale Zvicerane, Ligji Federal i Zvicrës, E drejta kantonale, Kantoni i Cyrihut, Procedura Civile e Zvicrës, Organizata Gjyqësore.

1. HYRJE

Zvicra është anëtare e sistemit të Europës Kontinentale. Megjithatë, vendimet e Gjykatës Federale Zvicerane kanë peshë të konsiderueshme. E drejta materiale e Zvicrës, u nënshtrohet ligjeve federale zvicerane. Megjithatë, nga aspekti i së drejtës gjyqësore, në gjykatat e secilës nga 26 kantonet Zvicerane, zbatohen rregulla të ndryshme juridiko-gjyqësore. Gjykimet në gjykatat Federale u nënshtrohen Ligjit Federal të së drejtës procedurale dhe Ligjit Federal për Organizimin Gjyqësor Federal. 26 kantonet, në të njëjtin segment posedojnë mënyra të fushëveprimit, posedojnë rregulla të ndryshme gjyqësore. Për shembull, nëse në një kanton, egzistojnë gjykata speciale tregtare për rastet tregtare, në tjetër kanton nuk egziston kjo ndarje. Sipas P. Georgit, kushtet e apelimit për një aktgjykim, ndryshojnë nga kantoni në kanton (P. Georg, 2018, p. 273). Përveç diversitetit të ligjeve që rregullojnë gjykimet që ndryshojnë sipas vendndodhjes së kantonit, nëse mirren parasysh disa ligje në nivel federal të cilat përmbajnë dispozita mbi gjykimet dhe nëse merret parasysh edhe egzistenca e të drejtës gjyqësore e cila është një hap para nga ana e Gjykatës Federale, e gjithë kjo gjë sjell një mosbesim ndaj sistemit juridiko-ligjor në Zvicër, i cili mosbesim shkakton çrregullime ligjore . Këtë gjë e konstaton Baumgarnet(S. Baumgarnet, 2007, p.301). Për arsye se nuk është e mundur për të marrë si shembull të gjitha procedurat gjyqësore nga të gjitha kantonet, me qëllim që të japim shembull në punimin tonë është marrur e drejta gjyqësore e kantonit të Cyrihut dhe në suaza të saj kemi analizuar Ligjin e procedurës civile dhe Ligjin mbi organizimin gjyqësor (G. Bovey, 2019). Pavarësisht rëndësisë tradicionale të ligjit kantonals, sot më shumë rregulla të gjyqësisë federale e kanë zënë vendin e të drejtës kantonale. Më 1 janar 2001 në fuqi hyri Ligji federal për të drejtën civile, dhe nga ajo datë në lidhje me kompetencat zbatohen rregullat nga ligji federal. Gjersa, disa çështje të caktuara procedurale u nënshtrohen rregullave të Kushtetutës Federative (*Federal Constitution of the Swiss Confederation, 1999*).

Përshkak se në Zvicër përdoren 4 gjuhë të ndryshme, secili kanton e ka vendosur gjuhën e tij zyrtare. Procedurat në kantonin e dhënë, patjetër duhet të inicohen në gjuhën zyrtare të atij kantoni. Siç është rasti me të drejtën gjyqësore federale, ashtu edhe në të drejtën gjyqësore kantonale rol të rëndësishëm kanë luajtur principet të cilat janë dominante në të drejtën gjyqësore civile zvicerane. Këto principe janë; parimi i kursimeve (*Sipas kodit të procedurës civile zvicerane, neni 54, 2016*), gjetja e dispozitës ligjore nga ana e gjyqtarit e cila do të zbatohet në procedurën gjyqësore, e drejta për dëgjimin e palëve procedurale në seancë (*Kushtetuta e Zvicrës, neni 29,1999*), autonomia dhe paanshmëria e gjykatave, e drejta për gjykim në kohëzgjatje të arsyeshme (*Kushtetuta e Zvicrës, 29,1999*) (*ZH Court Constitution Act of Switzerland, 1999,*), dhe natyra publike e procedurës gjyqësore (*Federal Constitution of the Swiss Confederation, 1999*).

2. SISTEMI I GJYKIMIT NË REPUBLIKËN E ZVICRËS DHE ORGANIZIMI GJYQËSOR KANTONAL

Gjyqësia kantonale është e organizuar në këtë mënyrë (Wolf & Adrian 2001):

Gjykatat e paqes

Nëse në ligj nuk parashihet ndryshe, gjykatat e paqes janë gjykata të shkallës së parë. Në këto gjykata janë të angazhuar 3 gjyqtarë. Mirëpo, tek rastet vlera e kontestit e cila variron nga nga 50 franga zvicerane në 20,000 franga zvicerane dhe tek lëndët ku praktikohet procedura e thjeshtë gjyqësore, thelbësore është që këto lëndë të udhëhiqen nga një gjyqtar i vetëm. Nëse një rast konkret vlen më pak se 500 franga zvicerane, në procedurën civile është i angazhuar një gjyqtar i vetëm

Gjykatat tregtare

Cyrih është një nga katër kantonet zvicerane me një Gjykatë Ekonomike (*Building Competence in Commercial Law in the Member States-study for the JURI Committee, 2018*). Gjykata Ekonomike është përgjegjëse për rastet e kontestuara ndërmjet kompanive të regjistruara në Regjistrin Tregtar, të cilat tejkalojnë vlerën prej 8,000 EURO dhe të cilat konteste janë shkaktuar nga natyra e biznesit. Padiësi, nëse pala e paditur është e regjistruar në regjistrin tregtar dhe me kusht që të përmbushen edhe kushtet e tjera, procedurën mund t'a inicoj pranë Gjykatës Ekonomike. Gjykata Ekonomike është gjithashtu përgjegjëse për fusha të tilla si patentat, markat tregtare dhe të drejtat e kartelave. Në gjykatat ekonomike, janë të angazhuar 5 gjyqtarë.

Gjykatat e veçanta

Në disa kantone, janë themeluar gjykatat e punës (Essenberg, 1986), të cilat janë përgjegjëse për kontestet në mes punëtorëve dhe punëdhënësve. Në kantonin Cirihi, vetëm në zonën e Cyrihut dhe zonën e **Winterthurit, egzistojnë gjykatat e punës**. Gjykatat për kontestet nga qiraja egzistojnë në të gjitha zonat e kantonit Curihi dhe gjithashtu në disa kantone tjera.

Gjykatat e larta kantonale

Deri tek gjykatat e larta kantonale (Ammann, 2018), mund të paraqitet ankesë kundër aktgjykimeve të sjella në gjykatat e paqes, gjykatat me një gjyqtar të vetëm dhe nga gjykatat e veçanta. Nuk ka mundësi për ankesa kundër aktgjykimeve të gjykatave tregtare në gjykatat e larta kantonale. Në disa raste, siç është emri i kompanisë ose

autorit, gjykata tregtare e kryen funksionin e një gjykate themelore. Gjukata tregtare, mund të bëj një marrëveshje për autorizim, me qëllim që, në rast se vlera e kontestit e kalon shumë prej 20.000 franga zvicerane, procedura të zhvillohet pranë Gjykatës së lartë kantonale. Në gjykatat e larta kantonale, janë të angazhuar gjithsej 3 gjyqtarë.

Gjykatat e apelit

Gjukata e Apelit (Matjaz, 2018) ekziston vetëm në tre kantone, njëra prej të cilave është kantoni i Cyrihut. Në Gjykatën e Apelit, paraqiten ankesa kundër aktgjykimeve të gjykatave të larta kantonale dhe atyre tregtare. Në gjykatën e apelit janë të angazhuar 5 gjyqtarë.

Gjukata Federale

Gjukata Federale (Tschümperlin, 2019) ekziston në Lausanne dhe Cyrih. Zakonisht, janë të angazhuar tre gjyqtarë, por në rastet kur ka interes të përgjithshëm në seancat dëgjimore, formohen komisione prej pesë gjyqtarësh. Në të kaluarën, ka qenë e mundur zgjidhja e kontesteve mes palëve në Gjykatat Federale, por me qëllim që t'i lehtësohet puna Gjykatës Federale, kjo mundësi u ç'fuqizua në vitin 2001. Gjukata federale është përgjegjëse si gjykatë themelore, (Fleiner, 2009) për kontestet në mes institucioneve federale dhe personave juridik dhe për kontestet në mes institucioneve kantonale dhe personave juridik. Të gjitha kontestet tjera, mund të paraqiten deri tek Gjukata Federale, nëse janë shterur të gjitha mundësitë kantonale dhe mjetet e tjera juridiko-ligjore. Gjukata Federale, në fusha të kufizuara, gjithashtu ushtron edhe funksionin e Gjykatës Kushtetuese. Përveç kësaj, gjykata federale gjithashtu zgjidh edhe kontestet që rrjedhin nga e drejta administrative dhe penale.

3. SPECIFIKIMET DOMINUESE TË GJYQËSISË KANTONALE

Ekzistojnë disa tipare të ndryshme të gjyqësorit kantonal. Gjykimi fillon në gjykatat kantonale. Megjithatë, sapo të plotësohen të gjitha kushtet dhe të shterren të gjitha mundësitë e tjera juridiko-ligjore, paraqitet ankesa deri tek gjykata federale. Nuk ka komisione në rastet (lëndët) ligjore. Meqë çdo objekt (lëndë konkrete), mund të udhëhiqet nga një gjyqtar i vetëm, ai mund të drejtohet edhe në gjykatat me komisione të përbëra nga 5 deri në 7 gjyqtarë. Asnjë hetim nuk mund të kryhet pa ndonjë qëllim të veçantë (Baumgartner, 2010). Njoftimet bëhen përmes gjykatës. Njoftimet e bëra nga ana e palëve procedurale nuk janë të vlefshme. Vlen principi i pagesës së shpenzimeve gjyqësore nga ana e palës procedurale e cila e ka humb rastin (kontestin gjyqësor). Nëse njëra nga palët, e ka fituar kontestin nuk lejohet marrveshja në mes palëve, sa u përket shpenzimeve gjyqësore (Goran, 2018). *Një nga karakteristikat interesante të gjyqësorit zviceran është se shumë gjykatës nuk janë jurist.* Me përjashtim të kantoneve të Cyrihut dhe Winterthurit, në gjykatat e paqes, kryetari i gjykatës dhe gjykatësit e gjykatave më të larta sipas profesionit janë jurist. Pjesa tjetër e gjyqtarëve, megjithatë, pothuajse të gjithë vijnë nga të gjitha profesionet e tjera. Gjyqtarët zgjidhen për t'u angazhuar për një periudhë të caktuar kohore. Në një numër kantonesh kjo periudhë është deri në gjashtë vjet. Gjykatësit nga gjykatat e paqes zgjidhen nga populli. Gjykatësit nga gjykatat më të larta dhe gjykata e apelit zgjidhen nga parlamenti vendor (Suter, 2014).

4. CONCLUSION

The trial in the Swiss Republic begins in the cantonal courts. However, as soon as all the conditions are met and all other legal possibilities are exhausted, a complaint is lodged with the federal court. In Switzerland, there are no commissions in legal cases. Since each object (concrete case) can be managed by a single judge, it can also be directed to the courts with commissions consisting of 5 to 7 judges. No investigation can be carried out without special purpose in Switzerland. Notices are made through the court. Notices made by the procedural parties are not valid. In Swiss civil law, the principle of payment of court costs by the procedural party which has lost the case (judicial dispute) applies. If one of the parties has won the dispute, the agreement between the parties regarding court costs is not allowed. One of the interesting features of the Swiss judiciary is that many judges are not lawyers. Also in Switzerland, with the exception of the cantons of Zurich and Winterthur, in the courts of peace, the president of the court and the judges of the highest courts by profession are lawyers. The rest of the judges, however, almost all come from all other professions. And the special feature of Switzerland as well, compared to other countries, is the fact that judges are elected to be engaged for a certain period of time. It is also worth noting that Curih is one of the four Swiss cantons with an Economic Court. The Economic Court is responsible for disputed cases between companies registered in the Commercial Register and which disputes are caused by the nature of the business. The plaintiff, if the respondent is registered in the commercial register and provided that other conditions are met, can initiate the procedure before the Economic Court. The Economic Court is also responsible for areas such as patents, trademarks and card rights. The specialization of judges influences the efficiency of the procedure, as well as the overall process of case management. The specialization of judges leads to better decision-making, especially in complex cases that require more specific knowledge. Their great experience and expertise will lead to better decisions, which will result in a better outcome of the proceedings. Therefore, in countries where there are no such courts, the workload of the regular courts increases, which results in slowness in the procedure (the case with our

country). Therefore, we believe that states that want to have a more stable and efficient judiciary, the establishment of a specialized trade or economic court will have a positive effect on the overall judiciary in the country and will lead to improved efficiency in dealing with trade disputes.

BIBLIOGRAPHY

- Baumgartner, S.P. (2007). - Class Actions and Group Litigation in Switzerland - *Northwestern Journal of International Law & Business*, Vol. 27, - U of Akron Legal Studies Research Paper No. 06-17; page 301-320.
- Baumgartner, S.P. (2010). *Civil Procedure Reform in Switzerland and the Role of Legal Transplants (Common Law, Civil Law and the Future of Categories*, 75 (Janet Walker & Oscar G. Chase eds.,) Research Paper No. 10-13; page 2-27.
- Bovey, G. M. (2019). *The Swiss Legal system and research*.
- Essenberg, B. (1986). *Labour courts in Europe -Proceedings of a meeting organised by the International Institute for Labour Studies(e book)*, page 57.
- Fleiner, T. (2009). *The Current Situation of Federalism in Switzerland*; REAF, núm. 9, octubre, page 58-61; 77-80.
- Linder, W., & Vatter, A. (2001). *Institutions and Outcomes of Swiss federalism: The Role of the Cantons in Swiss politics - January 2001*; *West European Politics* 24(2):95-122.
- Matjaz, S.- K. (2018). *Civil Procedure* , page 338,361, 362.
- Odile, A. (2018). *International Law in Domestic Courts Through an Empirical Lens: The Swiss Federal Tribunal's Practice of International Law in Figures (Swiss Review of International and European Law)-Volume 28, Number 4*; Schulthess, page 489, 517, 579.
- Picht, P. G. (2018). *Civil Law - Posted at the Zurich Open Repository and Archive, University of Zurich ; ZORA URL: <https://doi.org/10.5167/uzh-160651>; Originally published at: Picht, Peter Georg; Studen, Goran (2018). Civil Law. In: Thommen, Marc. *Introduction to Swiss Law*. Berlin: Carl Grossmann Verlag, 271-303. DOI: <https://doi.org/10.24921/2018.94115924>, page 273=275.*
- Suter, B. (2014). *Appointment, discipline and removal of judges: A comparison of the Swiss and New Zealand Judiciaries*; LLM Research paper *Laws 522: Judiciary*, page 5, 7, 13, 15, 3.
- Tschümperlin, P. (2019). *The Swiss Federal Supreme Court The Third Power within the Federal State (e book)*, page 4-10.
- Federal Constitution of the Swiss (2020) Confederation of 18 April 1999 (Status as of 1.1.2020); <https://www.admin.ch/opc/en/classified-compilation/19995395/index.html>
- ZH Court Constitution Act of Switzerland (2020), article 30; 95 & Federal Constitution of the Swiss Confederation of 18 April 1999 (Status as of 1 January 2020); Art. 29 General procedural guarantees.
- Civil Procedure Code of Switzerland, article 54.
- Building Competence in Commercial Law in the Member States (2018) (STUDY for the JURI Committee) ; Directorate General for Internal Policies of the Union Policy Department for Citizens' Rights and Constitutional Affairs PE 604.980- September 2018, page 7, 8, 9, 40, 58, 60, 61.